

Burrat dhe Gratë në Shqipëri

Blerina Subashi



- Të paraqesë të dhëna dhe tregues të ndarë sipas gjinisë në mënyrë periodike vjetore.
- T'i shërbejë monitorimit të politikave mbi arritjen e barazisë gjinore.
- T'i shërbejë përdoruesve të interesuar si një bazë për të analizuar në një kontekst më të gjerë barazinë gjinore.




Botimi është i organizuar në kapituj:

- Ligjet kombëtare në fushën e barazisë gjinore ndër vite (1995 – 2016)
 1. Popullsia
 2. Abortet
 3. Arsimi
 4. Punësimi
 5. Hendeku gjinor në paga (shoqëruar me një analizë në fund të botimit)
 6. Statistikat juridike
 7. Femrat në vendimmarrje
 8. Indeksi i pabarazisë gjinore
 9. Seti minimali treguesve gjinorë
 10. Përkufizime




Popullsia banuese sipas gjinisë


- Popullsia 1 Janar 2017-
50.5 % burra vs. 49.5 %
gra
- Popullsia 2016-2017 është
rritur me 0.03 %.
 - Popullsia e burrave
(-) 0.3 %
 - Popullsia e grave
(+) 0.4 %
- Migracioni neto pozitiv tek
popullsia e grave, si pasojë
e rënies së emigracionit të
tyre.




- Emigracioni prek më së shumti popullsinë në moshë pune.
- Gratë jetojnë më gjatë



- Në mënyrë natyrale lindin më shumë djem se vajza.
- Raporti në lindje mbetet ende mbi nivelin natyror (1,07 për vitin 2017).




- Çiftet preferojnë gjithnjë e më pak fëmijë (TFR 1.54 fëmijë për grua).
- Nën nivelin e zëvendësimit 2,1.
- Gratë janë larg zëvendësimit të vetes 25 %.




Lindshmëria sipas gjinisë

- ISF gratë- 1.54
- ISF burrat – 1.58
- Moshë mesatare në lindje e grave 27, 0 vjeç
- Moshë mesatare në lindje e burrave 32, 5 vjeç.




Lindshmëria në adoloshencë


- Ky tregues për të gjithë grupmoshën është 17.5 lindje për 1000 vajza të grupmoshës 15-19 vjeç.



- Gratë jetojnë mesatarisht 3 vite më gjatë.
- Kjo diferencë është ngushtuar me 2 vite në një dekadë.




- Mosha mesatare e martesës
 - Gratë 25,1 vjeç
 - Burrat 30,4 vjeç.
- Gjysma e martesave te vajzat realizohet para moshës 24 vjeç.
- Gjysma e martesave te djemtë realizohet para moshës 29 vjeç.




Martesat e hershme

- 6.5% e vajzave të moshës 18 vjeç janë të martuara vs 0.1 % të djemve.
- 8.2 % e vajzave të moshës 19 vjeç janë të martuara vs. 0.3 % të djemve.




- Në 2016 shënohen rreth 5000 aborte në 31 000 lindje.
- Raporti i abortit 170 aborte për 1000 lindje.
 - 78 % spontane
 - 22 % ndërprerje



Lindjet dhe abortet


- Përqindja më e madhe e lindjeve dhe aborteve kryhen në moshën 20-34 vjeç e cila është moshë më fertile.
- Ndërkohë në moshën mbi 34 vjeç kryhen vetëm 9 % e lindjeve, përqindja e aborteve të kryera është 26,3 %.
- Në këtë grupmoshë 1 në 2 lindje përfundojnë në abort.



Arsimi, pjesëmarrja sipas gjinisë

Indeksi i Barazise Gjimore (mbi GER)


Gender Parity Index (on GER)



- **Indeksi i barazisë gjimore në arsim:** Një indeks i barabartë me 1 tregon barazi gjimore, Më pak se 1.0 tregon pabarazi në favor të meshkujve dhe më i madhe se 1.0 pabarazi në favor të femrave.
- Sipas këtij indeksi pjesëmarrja në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar është më e lartë për djemtë (52 %).
- Ndërkohë në arsimin universitar kemi një pjesëmarrje më të lartë të vajzave (58 %)




Stafi mësimor



- Stafi mësimdhënës për arsimin parauniversitar është në favor të mësueseve gra të cilat përbëjnë më shumë se 70% të tyre.
- Gratë kryesojnë tek docentët dhe pedagogët pa tituj dhe doktorë.
- Ndërkohë në arsimin e lartë burrat dominojnë stafet mësimdhënës më të kualifikuar si profesor.




Nxënës dhe studentë me aftësi të kufizuar



- Këtë botim INSTAT ka përfshirë të dhëna për nxënësit dhe studentët me aftësi të kufizuar sipas nivelit arsimor.
- Pjesëmarrja e vajzave me aftësi të kufizuara rritet me rritet e nivelit arsimor, nga 35,1% në arsimin 9 vjeçar në 45,5 % në arsimin e lartë.




Pjesëmarrja në forcën e punës



- Burrat kanë një pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës sesa gratë, respektivisht 74,1% dhe 58,3%.
- Normat e papunësisë së grave janë më të ulta se të burrave (14,6 % vs 16,4 %) – gratë më shumë inaktive (15, 8 pikë përqindje).

Arsyet e inaktivitetit



- 21,5 % e grave deklarojnë se arsyeja e inaktivitetit në tregun e punës lidhet me detyrimin për përbushjen e detyrat shtëpiake, vetëm 1% e burrave e deklarojnë këtë si arsye inaktiviteti.



- Gratë paguhen mesatarisht 93,7% të pagës së burrave
 - HGJP- 6.3 %.
- Dy faktorë për tu marrë në konsideratë
 - 1) Niveli i ulët i pagave në përgjithësi
 - 2) Pjesëmarrja më e ulët e grave në tregun e punës


Analiza sipas sektorëve

- Pjesëmarrje shumë të ulët, si ndërtimi (4 %) , HGJP është negativ (-1,3 %) Në këtë sektor pranohen nga punëdhënësit gra më të arsimuara dhe të kualifikuara.
- Pjesëmarrje të lartë të grave, si prodhimi (57 %) dhe HGJP në pagë është më i lartë (23, 3 %) si pasojë e një pune relativisht më pak të kualifikuar të grave



- **Analiza sipas profesioneve**
- Pjesmarrje të lartë dhe pagat e larta, si psh tek grupprofesioni i drejtuesve, profesionistëve dhe teknikëve (51 %), niveli i HGJP është 12,7 % .
- Pjesmarrje e lartë si grupprofesioni punonjës i bujqësisë, pyjeve dhe peshkimi (43 %) dhe nivel pagash i ulët, HGJP 3,6 %.





- **Gratë janë autore të:**


- Mashtrime
- Fallsifikim monedhash
- Korrupsion

- **Burrat janë autorë të:**

- Vrasjeve të mbetura në tentativë
- Krime seksuale
- Vrasje



Dhuna në familje




- Gjatë vitit 2016, 3700 persona janë regjistruar si të dëmtuar nga dhuna në familje, prej të cilëve – 76% gra kundrejt 24% burra.
- Gratë që denoncojnë dhunë në familje vijnë në përqindje më të lartë nga qarqet e Tiranës (36,5%) Durrësit (14,9%)
- Numri i raportimeve jo gjithmonë duhet interpretuar si shtim i fenomenit.
- Dhuna duhet së pari të perceptohet si e tillë e më pas të raportohet.




Gratë në vendim-marrje

- Përfshirja e grave në parlament ka një rritje të ndjeshme.
- Viti 2016 shënon përqindjen më të lartë që nga 2008, ku u vendos kuota gjinore në parlament.

Gratë parlamentare



Pjesëmarrja e grave në komisionet parlamentare




- Përfaqësimi i grave në komisionet parlamentare nuk e tejkalon 50 %.
- Përfaqësim më të lartë në komisionin për punën, çështjet sociale dhe shëndetësinë.
- Në komisionin e sigurisë kombëtare gratë nuk kanë asnjë përfaqësuese.



Burrat dhe gratë kredimarrës

Në krahasim me një vit më parë

- Numri i kredimarrësve
 - Gra është rritur 17 %
 - Burra është ulur 28 %
- Numri i kredive
 - Të marra nga gratë ka rënë 4 %
 - Të marra nga burrat është rritur 5 %.
- Vlera mesatare e kredisë së marrë nga burrat është mesatarisht 1.4 herë më e madhe se e grave.



Në vitin 2016 gratë:

- Drejtojnë 26,8 % të ndërmarrjeve aktive
- Drejtojnë 24,0 % të ndërmarrjeve të krijuara këtë vit.
- Drejtojnë kryesisht ndërmarrjet e vogla me më pak se 10 punonjës.
- Drejtojnë ndërmarrje që prodhojnë shërbime (33,3 %) krahasuar me ndërmarrjet që prodhojnë të mira (11,7 %).
- Janë më së shumti prezente në Tiranë (40.7 %), Fier (9.7 %) dhe Durrës (8.8 %).



Ju faleminderit për vëmendjen!

